



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORË

Nr. 534 prot.(E.Sh)

Vlorë më datë 04.06 .2021

Lënda : Dërgohet për njohje vendimi i mosfillimit.

Shtetasit: *Gazmend Bardhi*

Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Demokratike të Shqipërisë

TIRANË

Bashkëlidhur kësaj shkrese ju dërgojmë për njohje vendimin e mosfillimit të materialit kallëzues **Nr.822** të vitit **2021**, rregjistruar pranë kësaj prokurorie.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTUESI I PROKURORISË

Aurel ZARKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORË

V E N D I M
PËR MOSFILLIMIN E PROCEDIMIT PENAL

Në Vlorë, më 19.05.2021, unë Erjon Shqarri, Prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, pasi studiova materialin kallëzues me nr 822, datë 19.04.2021;

KONSTATOVA :

Në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, është regjistruar materiali kallëzues nr 822, datë 19.04.2021, ardhur për kompetencë, nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë, me shkresën nr 325/1 prot, datë 15.04.2021.

Ky material kallëzues është regjistruar nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë, me nr 325, datë 14.04.2021, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit Gazmend Bardhi, si përfaqësues i Partisë Demokratike të Shqipërisë, kundër shtetasve [REDACTED] me detyrë [REDACTED], [REDACTED] me detyrë [REDACTED] Vlorë, dhe [REDACTED] me detyrë [REDACTED] për kryerjen e veprave penale të "Shpërdorimi i detyrës", "Korrupsioni aktiv në zgjedhje", "Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore", "Marrja ose përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit", dhe "Grupi i strukturuar kriminal", të parashikuara nga nenet 248, 328, 328/a, 331/a dhe 333/a të Kodit Penal.

Pas studimit të materialit kallëzues nga kjo Prokurori, është arritur në konkluzionin se, nuk ka të dhëna për veprat penale të "Korrupsionit aktiv në zgjedhje" apo të "Grupit të strukturuar kriminal", të parashikuara nga nenet 328 dhe 333/a të Kodit Penal, pavarësisht faktit se në kallëzim pretendohet për veprime abuzive të shtetasit [REDACTED] me detyrë [REDACTED]

[REDACTED], Drejtori i [REDACTED] dhe [REDACTED]



me detyrë [REDACTED], me qëllim përdorimin e administratës publike në fushatë, nën presionin e largimit nga puna, përdorimin e ambienteve të institucioneve dhe asetëve të tjera publike në fushatë, si dhe mbledhjen e kartave ID, për të detyruar shtetas të votojnë në një mënyrë të caktuar apo për të mos i lejuar ato që të shkojnë të votojnë në zgjedhjet elektorale të datës 25 prill 2021. Këto veprime mund të kualifikohen në kuadër të veprave penale të “Shpërdorimit të detyrës”, “Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, “Marrjes ose përdorimit të paligjshëm të dokumenteve të identifikimit”, të parashikuara nga nenet 248, 328/a dhe 331/a të Kodit Penal.


Në këto rrethana, pavarësisht pretendimit të kallëzuesit për veprat penale të kryera, konstatohet që materiali përmban indicie që referojnë për vepra penale që nuk janë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, referuar nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, apo subjekte të Posaçëm, referuar nenit 3 të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, dhe kompetente për hetimin e këtyre veprave penale është Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

Nga materiali hetimor rezulton se në kallëzim janë parashtruar rrethanat e faktit, dhe konkretisht:

Në 25 Prill do të zhvillohen zgjedhjet parlamentare, dhe prej disa kohësh ka filluar organizimi i partive politike dhe subjekteve zgjedhore.

Në këtë kuadër, javët e fundit është vënë re shtim në masë i veprimeve të kundraligjshme nga ana e qeverisë, në funksion të ndikimit tek vullneti i qytetarëve, dhe ndryshimit me çdo mjet dhe mënyrë të paligjshme të rezultatit të zgjedhjeve.

Shtetasit [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] Drejtor i [REDACTED] dhe [REDACTED] [REDACTED], kanë krijuar një grup të strukturuar kriminal, me qëllim blerjen e votës, ndryshimin e rezultatit të zgjedhjeve dhe maksimizimin në mënyrë të paligjshme të votës për Partinë Socialiste, në zgjedhjet e 25 prillit, duke konsumuar veprat penale të “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248, “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” parashikuar nga neni 328/a, “Marrja ose përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit” parashikuar nga neni 331/a dhe “Grupit të strukturuar kriminal” parashikuar nga neni 333/a të Kodit Penal.

A handwritten signature in black ink is written over a circular official stamp. The stamp is partially obscured by the signature and contains some illegible text and a central emblem.

Në shpërdotim të detyrës, këta shtetas po përdorin administratën publike në fushatë, nën presionin e largimit nga puna, po përdorin vendet e punës në administratë nëpërmjet emërimeve politike në këmbim të votës, ambientet e institucioneve dhe asete të tjera publike në fushatë, legalizimet dhe cdo certifikatë tjetër dhënë nga ASHK' në këmbim të votës, favorizimin dhe faljen e detyrimeve ndaj OSHEE në këmbim të votës. Japin para në dorë në këmbim të votës, si dhe mbledhin në këmbim të parave të kartat e ID për të mos lejuar qytetarët që nuk votojnë PS të shkojnë dhe të votojnë në 25 prill.

Duke analizuar materialin hetimor, konstatohet se përveç kallëzimit penal, në dosje nuk ka bashkëngjitur asnjë prove apo dokument ku bazohet kallëzimi.

Për këtë fakt, në datën 04.05.2021, është njoftuar me telefon nga oficeri i policisë gjyqësore, për tu paraqitur në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, kallëzuesi Gazmend Bardhi, por nuk është bërë i mundur njoftimi i tij.

Në datën 07.05.2021, është njoftuar me telefon për tu paraqitur në prokurorinë Vlorë, shtetasi Gazmend Bardhi, për të dhënë deklarime lidhur me kallëzimin e bërë nga ana e tij, si dhe për të paraqitur prova, ku mbështetet kallëzimi. Ky shtetas ka njoftuar se kishte lënë si përfaqësuese shtetasen [REDAKTUAR] që të ndiqte në vazhdimësi kallëzimin, për shkak të ngarkesës që kishte.

Po në datën 07.05.2021, është njoftuar me telefon për tu paraqitur në Prokurorinë Vlorë, shtetasja [REDAKTUAR], e autorizuar nga shtetasi Gazmend Bardhi, për të dhënë shpjegime dhe për të paraqitur prova lidhur me kallëzimin penal. Kjo shtetase ka njoftuar se e kishte të pamundur paraqitjen në Prokurorinë Vlorë, por do të autorizonte një person tjetër lidhur me këtë fakt, emrin e të cilit do ta jepte më pas.

Në datën 10.05.2021, është njoftuar me telefon përsëri shtetasja [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] i është kërkuar emri i personit të autorizuar për të dhënë shpjegime dhe prova lidhur me kallëzimin. Kjo shtetase ka njoftuar se kishte autorizuar shtetasin [REDAKTUAR], përfaqësuesin e Partisë Demokratike, dega Vlorë.

Në datën 11.05.2021, është njoftuar me telefon shtetasi [REDAKTUAR], për tu paraqitur pranë Prokurorisë Vlorë, për të dhënë shpjegime lidhur me kallëzimin e paraqitur nga Partia Demokratike, si dhe prova ku mbështetej

